



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 26 janar 2015
Nr. ref.:RK762/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastet Nr. KI80/14 dhe KI93/14

Parashtrues

Gazmend Musollaj dhe Nezir Kerrellaj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit
të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 166/13, të 6 nëntorit 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesat janë dorëzuar nga z. Gazmend Musollaj nga fshati Gurakoc, komuna e Istogut dhe z. Nezir Kerrellaj nga fshati Serbobran, komuna e Istogut (në tekstin e mëtejme: parashtruesit). Z. Gazmend Musollaj (KI80/14) përfaqësohet nga z. Zenel Mekaj, avokat nga Peja, ndërsa z. Nezir Kerrellaj (KI93/14) përfaqësohet nga z. Zeqir Bërdynaj, avokat nga Peja.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit kontestojnë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Pml. nr. 166/13, të 6 nëntorit 2013 (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), me të cilin është refuzuar si e pabazuar kërkesa e tyre për mbrojtjen e ligjshmërisë.
3. Aktgjykimi i kontestuar iu dorëzua parashtruesve më 23 dhjetor 2013.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme.
5. Parashtruesi Gazmend Musollaj (KI80/14) pretendon se aktgjykimi i kontestuar *“ia ka shkelur të drejtën kushtetuese të garantuar nga neni 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] paragrafi 4 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës”* (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).
6. Parashtruesi Nezir Kerrellaj (KI93/14) pretendon se me aktgjykimin e kontestuar i janë shkelur *“të drejtat e garantuara me Kushtetutë, përkatësisht neni 3 [Barazia Para Ligjit], neni 19 [Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare], dhe neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]”*.

Baza juridike

7. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

8. Më 8 maj 2014, parashtruesi Gazmend Musollaj (KI80/14) parashtrroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata). Më 22 maj 2014, parashtruesi Nezir Kerrellaj parashtrroi kërkesë (KI93/14) në Gjykatë.
9. Më 10 qershor 2014, Kryetari i Gjykatës, caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
10. Më 18 qershor 2014, në pajtim me rregullin 37 (1) të Rregullores së punës, Kryetari urdhëroi që kërkesa KI93/14 të bashkohet me kërkesën KI80/14 dhe që gjyqtari raportues dhe Kolegji shqyrtues për të dy rastet (KI80/14 dhe KI93/14) të jenë të njëjtë ashtu siç ishte vendosur në kërkesën KI80/14.
11. Më 20 qershor 2014, Gjykata i njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesave KI80/14 dhe KI93/14 dhe bashkimin e tyre. Gjykata po ashtu iu kërkoi

parashtruesve që të dorëzojnë autorizimet për përfaqësim për z. Zenel Mekaj dhe z. Zeqir Bërdynaj, si dhe t'i plotësojnë kërkesat e tyre. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi Gjykatës së Apelit nga një kopje të këtyre kërkesave.

12. Më 30 qershor 2014, parashtruesi Gazmend Musollaj (KI80/14) dorëzoi dokumentet shtesë, të kërkuara nga Gjykata.
13. Më 4 shtator 2014, Gjykata i kërkoi Gjykatës Themelore në Pejë të dorëzojë fletëkthesën që tregon datën në të cilën parashtruesve u është dorëzuar Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, të cilin e kontestojnë.
14. Më 12 shtator 2014, parashtruesi Nezir Kerrellaj (KI93/13) dorëzoi dokumentet shtesë të kërkuara nga Gjykata.
15. Më 16 shtator 2014, Gjykata Themelore në Pejë paraqiti informatat shtesë të kërkuara nga ana e Gjykatës.
16. Më 18 shtator 2014, Gjykata i dërgoi Gjykatës Supreme një kopje të kërkesave KI80/14 dhe KI93/14.
17. Më 25 nëntor 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

18. Më 29 mars 2012, Gjykata e Qarkut në Pejë (Aktgjykimi, P. Nr. 473/11), i shpalli fajtorë parashtruesit për kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë në bashkëkryerje. Parashtruesi Gazmend Musollaj (KI80/14) u shpall fajtor edhe për kryerjen e veprës penale të mbajtjes në pronësi, kontrollit, apo posedimit të pa autorizuar të armëve.
19. Parashtruesi Gazmend Musollaj (KI80/14) u dënua me burgim afatgjatë me kohëzgjatje prej 27 (njëzet e shtatë) vjetësh, kurse parashtruesi Nezir Kerrellaj (KI93/14) u dënua me burgim prej 15 (pesëmbëdhjetë) vjetësh.
20. Prokurori Publik i Gjykatës së Qarkut në Pejë dhe përfaqësuesi i të dëmtuarës Z. A. parashtruan ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, në lidhje me kohëzgjatjen e dënimit.
21. Më 12 dhjetor 2012, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktgjykimi Ap. nr. 391/2012) e zëvendësoi dënimin e mëparshëm të parashtruesit Gazmend Musollaj (KI80/14) me burgim afatgjatë prej 32 (tridhjetë e dy) vjetësh, ndërsa dënimin e mëparshëm të parashtruesit Nezir Kerrelaj (KI93/14) e zëvendësoi me burgim afatgjatë prej 30(tridhjetë) vjetësh.
22. Parashtruesit parashtruan ankesë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme (Ap. nr. 391/2012, të 12 dhjetorit 2012).
23. Më 21 mars 2013, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktgjykimi Pa. II. nr. 1/2013) refuzoi si të pabazuara ankesat e parashtruesve dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Supreme.

24. Kundër këtij aktgjykimi, parashtruesit kanë parashtruar kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme.
25. Më 6 nëntor 2013, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktgjykimi Pml. nr. 166/2013) i refuzoi si të pa bazuara kërkesat e parashtruesve për mbrojtje të ligjshmërisë, duke vlerësuar se “[...] gjykata e shkallës së parë, shkallës së dytë e po ashtu edhe ajo e shkallës së tretë, drejtë kanë aplikuar ligjin penal kur kanë përfunduar se në veprimet e të gjykuarve qëndrojnë elementet e veprës penale për të cilat të gjykuarit janë shpallë fajtor [...]”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Parashtruesi Gazmend Musollaj (KI80/14) pretendon se është shkelur paragrafi 4, i nenit 33 të Kushtetutës [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale]. Ai pretendon:

“[...] është shkelur parimi i përgjithshëm, ku duhet të veprohet në favor të tij, sepse nga gjykata e shkallës së parë, i gjykuari Musollaj, për vepra penale të cekura më lart, është dënuar me burgim afatgjatë prej 27 vitesh, derisa gjykata e shkallës së dytë e ndryshon vendimin e shkallës së parë dhe i shqipton dënim me burgim afatgjatë prej 30 vitesh, pa hy në fuqi Kodi i ri Penal, ndërsa gjykata e shkallës së tretë, refuzon ankesat e mbrojtësve dhe vërteton aktgjykimin e shkallës së dytë, në seancën e mbajtur, pas hyrjes në fuqi të Kodit të ri Penal, që do të thotë se vendimi nuk ishte ende i plotfuqishëm”.

27. Parashtruesi, Nezir Kerrellaj (KI93 /14) pretendon shkeljen e nenit 3 [Barazia Para Ligjit], nenit 19 [Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare] dhe nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës. Ai pretendon:

“[...] në rastin konkret duhet respektuar ligji i cili është më i favorshëm për të akuzuarin pra ligji i cili ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale e që dënimi ishte i shqiptuar 15 vite dhe ka mundur t'i shqiptohet më së shumti gjer në 20 vite burg e jo në 30 vite burg siç kanë vepruar Gjykatat [...]”.

Pranueshmëria e kërkesës

28. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesit i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
29. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, që përcakton:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.

30. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse: [...] (c) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesi, [...]”.

31. Gjykata vëren se aktgjykimi i kontestuar u është dorëzuar parashtruesve të kërkesës më 23 dhjetor 2013.
32. Gjykata vëren se parashtruesi Gazmend Musollaj (KI80/14) e ka parashtruar kërkesën e tij më 8 maj 2014, ndërsa parashtruesi Nezir Kerrellaj (KI93/14) e ka parashtruar kërkesën e tij më 22 maj 2014.
33. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesit i kanë parashtruar kërkesat e tyre në Gjykatë pas afatit kohor prej katër muajsh, në bazë të nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës.
34. Gjykata përkujton që qëllimi i afatit ligjor prej katër muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit si dhe rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë sigurinë juridike duke siguruar që rastet të cilat paraqesin çështje kushtetuese të shqyrtohen brenda afateve të arsyeshme si dhe që vendimet e nxjerra më herët të mos jenë pafundësisht të hapura për kontestim (Shih, rastin *O’Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 23274/04, GJEDNJ, Vendimi i 25 gushtit 2005).
35. Nga se u tha më lart, rrjedh që kërkesa është e paafatshme dhe duhet të refuzohet si e papranueshme në bazë të nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe rregullave 36 (1) c) dhe 56 (b) të Rregullores së punës, më 25 nëntor 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani